



C.nr. 789/15

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Enes Mehmeti, me sekretaren juridike Minire Krasniqi, në çështjen juridike të inicuar me padinë e paditësve: [redacted] dhe [redacted] që të dy nga fsh. [redacted] K. [redacted] kundër të paditurve: [redacted] dhe [redacted] që të dy më parë nga fsh. [redacted], K. Ferizaj, tani me adresë të panjohur, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm, avokati [redacted] nga Ferizaj, për shkak të vërtetimit të së drejtës së pronësisë, në seancën e mbajtur më datën 22.05.2017 ka marrë dhe publikuar këtë:

A K T G J Y K I M

- në bazë të pohimit -

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit [redacted] nga fsh. [redacted] K. [redacted], dhe **VËRTETOHET** se paditësi [redacted] është pronar me 1/1 të pjesës ideale të parcelës nr. **837** në sipërfaqe prej **1844m²** që gjenden në vendin e quajtur “Lugë” Z.K. Babush i Serbëve, K. Ferizaj.

II. OBLIGOHET i padituri: [redacted], që paditësit t’ia njej të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë dhe të durojë regjistrimin e saj në regjistrat kadastral në emër të paditësit, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimit, në të kundërtën ky aktgjykim do t’i shërben paditësit si autorizim për të bërë regjistrimin e pronës në emër të tij.

III. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e e paditësit të dytë [redacted] nga fsh. [redacted] K. [redacted] e ushtruar kundër të paditurit [redacted]

IV. OBLIGOHEN paditësit që të bëjnë pagesën e taksës për aktgjykim në shumë prej 50€, në afat prej 15 ditësh pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit me forcë.

A r s y e t i m i

Paditësit kanë pretenduar me padi se në vitin 1980 e kanë blerë paluajtshmërinë nga të paditurit në bazë të marrëveshjes gojore dhe atë, parcelën nr. 835 në sipërfaqe prej 1654m² e kanë blerë prej të paditurit [redacted] e në të njejtën kohë e kanë blerë edhe parcelën nr. 837 në sipërfaqe prej 1844m² nga i padituri tjetër [redacted] dhe për të njejtën paluajtshmëri, në bazë të kësaj kontrate, e kanë paguar në tërësi çmimin e shitblerjes. Pasi që të njejtit i kanë përmbushur në tërësi detyrimet lidhur me pagesën e çmimit, menjëherë e kanë marrë në posedim të papenguar pronën nga të paditurit. Paditësit nuk kanë mundur me kohë të vërtetojnë kontratën

e shitblerjes në gjykatë, për shkak se siç shprehen paditësit, neglizhencës dhe jo efikasitetit të organeve përkatëse administrative në Kosovë.

Për të vërtetuar pretendimet e tyre, paditësit kanë ofruar si dëshmi certifikatat e pronësisë në emër të të paditurve, me nr. UL-72209079-00016 dhe UL-72209079-00020 si dhe kanë propozuar që në cilësinë e dëshmitarëve të thirrën: [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] të dy nga fsh. [REDAKTUAR], K. [REDAKTUAR]

Gjykata, fillimisht, ka aprovuar propozimin e paditësve që të paditurve t'u caktohet përfaqësuesi i përkohshëm, meqenëse të njejtëve nuk u dihet adresa aktuale e banimit dhe kështu, me aktvendim C.nr.789/15 të datës 24.08.2015 u'a ka caktuar av. [REDAKTUAR] nga Ferizaj, si përfaqësues i përkohshëm i të paditurve.

Gjykata, aktvendimin për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm e ka publikuar në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në tabelën e shpalljeve të kësaj gjykate.

Përmes parashtresës së datës 16.08.2016 paditësi i dytë [REDAKTUAR] deklaroi se heqë dorë nga padia dhe kërkesëpadia e paraqitur, sepse me të paditurin [REDAKTUAR] kanë rënë në kontakt dhe janë në bisedime për bartjen e pronësisë me marrëveshje, prandaj në parashtresë thekson se nuk ka më interes juridik për të qenë palë paditëse.

Ndërsa paditësi i parë [REDAKTUAR] në seancën për shqyrtimin kryesor të mbajtur më 25.08.2016 ka deklaruar se vëllau i tij [REDAKTUAR] është tërhequr nga padia kundër të paditurit të dytë [REDAKTUAR] ndërsa vetë mbetet në tërësi pranë theksimeve në padi dhe i propozon gjykatës që të vazhdon seancën me paditësin e vetëm [REDAKTUAR] kundër të paditurit të vetëm [REDAKTUAR] duke propozuar që të bëhet dëgjimi i dëshmitarëve të propozuar. Në seancën e dytë për shqyrtimin kryesor, të mbajtur më 22.05.2017 paditësi propozon të dëgjohet si dëshmitar edhe dëshmitarin [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR], K. [REDAKTUAR]

Dëshmitari [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] deklaroi se paditësit i ka kusherinjë dhe se ai e di mirë faktin se para 30-40 vitesh, paditësit e kanë blerë tokën nga [REDAKTUAR] ('[REDAKTUAR] i gat', ashtu e kemi pas quajtur [REDAKTUAR] në atë kohë). Dëshmitari mëtej vazhdon, se në atë kohë ai ka punuar në zyrën e vendit në Babush të Serbëve, dhe edin që pas shitblerjes së tokës, kishte shkuar në familjen e paditësve, te babai i tyre Islami. Sipas tij, paditësit pastaj kanë ndërtuar shtëpi në pronën kontestuese. Dëshmitari në fund deklaroi se i kishte takuar edhe të paditurit, të cilët ia kishin konfirmuar shitjen e pronës kontestuese dhe i kishin treguar dëshmitarit se e kishin blerë një shtëpi në Serbi. Mëtej ai përfundon se meqë në atë kohë ishte zyrtar në zyrën e gjendjes civile, e dinte mirë se familjarët e të paditurve të gjithë janë shpërngulur në Serbi, ndërsa në Kosovë kishin mbetur vetëm disa pleqë.

Dëshmitari, [REDAKTUAR] nga fsh. [REDAKTUAR] K. [REDAKTUAR] deklaroi se pronën kontestuese e ka blerë babai i paditësve, dhe se ia ka paguar në tërësi çmimin e shitblerjes serbëve, në shumë dikun prej 35,000 eurosh me vlerën e tanishme. Dëshmitari mëtej shton se paditësit nga ajo kohë e deri më tani e kanë në shfrytëzim këtë pronë, ku në vitin 1986 e kanë ndërtuar shtëpinë, dhe

paskëtej nuk ka ndëgjuar të ketë pasur ndonjë ankesë apo problem nga të paditurit rreth kësaj prone.

Eksperti i gjeodezisë, gjeo. [REDAKTUAR] pas daljes dhe këqyrjes në vend, ka përpiluar raportin me shkrim të datës 26.04.2017, në të cilin ka deklaruar se: prona kontestuese gjendet në vendin e quajtur "Lugë" Z.K. Babush i Serbëve, K. Ferizaj, e përbërë prej parcelës me nr. 837 në sipërfaqe prej 1844m², e listuar në emër të [REDAKTUAR] në të cilën janë të ndërtuara: tarasa e shtëpisë, pemishte, dhe shakt i hidroforit, pus uji si dhe rruga private që shpie deri te shupa e paditësit, një pjesë e mbjellur me grurë.

Në fjalën përfundimtare, paditësi i vetëm, deklaroi se mbetet pranë thënieve në padi dhe njëherit konsideron se në këtë procedurë janë administruar provat materiale nga të cilat vërtetohet themelsia e kërkesëpadiës, siç janë: kontrata e shitblerjes dhe autorizimet e dhëna për këtë shitblerje, dhe gjithashtu dëshmia e dëshmitarëve, avokat [REDAKTUAR] si hartues i kontratës së shitblerjes dhe dëshmitar i përmbushjes së kontratës, si dhe dëshmitari [REDAKTUAR] i cili deklaroi se paditësi e mban pronën e blerë në posedim dhe shfrytëzim të papenguar dhe me mirëbesim për më shumë se 10 vite, ku kanë ndërtuar shtëpitë e tyre, ku jetojnë me dekada. Prandaj, paditësi deklaroi dhe i propozoi gjykatës ta miratojë kërkesëpadinë e tij në tërësi, si të bazuar në ligj.

Në fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurit, deklaroi se meqenëse u administruan të gjitha provat rreth kësaj çështjeje, ia lë gjykatës që të vendos për të drejtën e paditësit.

Gjykata ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të pohuar duke qenë se në mes palëve ndërgjyqëse nuk ishin kontestuese faktet vendimtare të çështjes dhe se i padituri respektivisht përfaqësuesi i përkohshëm i tij, shprehimisht ka pranuar kërkesëpadinë duke i pranuar faktet dhe provat e propozuara si të vërteta dhe në anën tjetër, gjykata nga shqyrtimi i gjithmbarshëm i çështjes nuk ka gjetur ndonjë rrethanë, për të cilën duhet kujdesur kryesisht, e cila do të pengonte aprovimin e kërkesëpadiës dhe rrethana tjera që t'i vënte në kundërshtim faktet dhe provat e çështjes me pohimin e kërkesëpadiës nga ana e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurit, ndaj në kuptim të nenit 148 të LPK-së, ka nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, *(në qoftë se i padituri deri në përfundimin e shqyrtimit kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep, pa shqyrtim të mëtejshëm, aktgjykimin me të cilin e aprovon pjesën apo gjithë kërkesëpadinë (aktgjykimi në bazë të pohimit)).*

Gjykata ka obliguar paditësin që të paguaj shpenzimet e procedurës dhe atë për aktgjykim në shume prej 50€, në bazë të nenit 445 të LPK-së.

Mbi bazën e parashtrimeve të mësipërme është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërsa, Gjykata ka vendosur për paditësin e dytë, si në pjesën e tretë të dispozitiv të Aktgjykimit, duke u bazuar në nenin 409.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ

C.nr. 789/15, me datën 22.05.2017



KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.

